



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENER GjISË
Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.11.2023

MBLEDHJA Nr. 58,
Datë 14.11.2023, ora 12:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Martë, datë 14.11.2023, ora 12:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 57 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbal-ve të mbledhjeve të bordit të ERE-s më datë 23.10.2023, datë 30.10.2023 dhe datë 08.11.2023.
2. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “GERTI” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “Mireshi” me fuqi të instaluar 1.900 MW.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “KARAVASTA SOLAR” shpk për marrjen e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të saj si mjet (barrë siguruese) për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.
4. Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore për pagesat e rregullimit të vitit 2023 të pashlyera ndaj ERE-s.
5. Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr.72, datë 13.03.2023, “Mbi licencimin e shoqërisë “SUN AVENUE” sh.p.k në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 MW.
6. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.03.2023, “Mbi licencimin e shoqërisë “SUNPOWER 2017” sh.p.k në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 MW
7. Çështje të tjera.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI